



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi

Mbledhja nr. 49

Prishtinë, më 17.12.2018, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Ismajl Kurteshi, kryetar, Teuta Haxhiu, Mufera Shinik, Fidan Rekalju, Abdyl Salihu, Driton Çausi, Arbërie Nagavci dhe Albulena Balaj–Halimaj.

Munguan: Valentina Bunjaku–Rexhepi, Verica Çeraniq dhe Nezir Çoçaj.

Përfaqësues tjerë: Mevlide Shamolli-MF, përfaqësues të zyrës së BE-së, KDI dhe përfaqësues të mediave.

Stafi mbështetës i komisionit: Lule Ymeri dhe Shaip Goxhuli.

Mbledhjen e kryesoi, Ismajl Kurteshi, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 5.12.2018 dhe 10.12.2018;**
- 3. Shqyrtimi i raportit me rekomandime për Projektligjin nr.06/L-073 për statusin e punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës nga viti shkollor 1990/91 deri në vitin shkollor 1998/99;**
- 4. Takim i komisionit me anëtarët e Këshillit Shtetëror të Cilësisë të AKA- së;**
- 5. Të ndryshme.**

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së komisionit dhe e hapi mbledhjen me propozimin për heqjen nga rendi të pikës së katërt: **Takim i komisionit me anëtarët e Këshillit Shtetëror të Cilësisë të AKA**, me arsyetimin se përfaqësuesit e ftuar janë në vizitë jashtë vendit.

1. Miratimi i rendit të ditës

Anëtarët e komisionit miratuan rendin e ditës.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 5 dhe 10.12.2018

Procesverbalet e dy mbledhjeve u miratua pa vërejtje, me sugjerimin e anëtares së komisionit Arbërie Nagavci që të njëjtat të dërgohen paraprakisht në formë elektronike.

3. Shqyrtimi i raportit me rekomandime për Projektligjin nr.06/L-073 për statusin e punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës nga viti shkollor 1990/91 deri në vitin shkollor 1998/99

Ismajl Kurteshi tha se komisioni ka punuar gjatë në Projektligjin nr.06/L-073 për statusin e punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës nga viti shkollor 1990/91 deri në vitin shkollor 1998/99, me qëllim që të kemi një ligj të zbatueshëm dhe në të njëjtën kohë të jetë i përballueshëm për buxhetin e shtetit.

Ai tha se komisionet e përhershme të Kuvendit e kanë shqyrtuar raportin me amendamente të Komisionit Funkcional dhe kanë konstatuar se amendamentet e propozuara janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë dhe nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Në vazhdim sqaroi se nga Ministria e Financave, e cila në koordinim me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, është kërkuar ndryshim në tekstin e amendamentit 2, që i referohet nenit 1 dhe amendamentit 11 që i referohet nenit 7 e që ka të bëjë me zëvendësimin e fjalës **”pensionin bazë”** me fjalën **”pensionin që realizon”**, kjo për arsye të heqjes së dilemave gjatë zbatimit të ligjit duke pasur parasysh se ekzistojnë disa skema pensionale.

Teuta Haxhiu tha se nuk e ka të qartë se çfarë nënkupton ky propozim ndryshim, andaj kërkoi që të sqarohet nga përfaqësuesi i Ministrisë së Financave.

Albulena Balaj-Halimaj tha se e përkrah propozimin e Ministrisë së Financave nga se ndikon pozitivisht në zbatim të ligjit.

Arbërie Nagavci, në diskutimin e saj, tha se proceduralisht a kemi të drejtë ta bëjmë këtë ndryshim duke pasur parasysh se këto amendamente janë shqyrtuar në komisionet e përhershme.

Abdyl Salihu, në diskutimin e tij, propozoi që të ftohen përfaqësuesit e ministrisë për ta sqaruar propozimin e tyre dhe të mos ketë dilema gjatë zbatimit të Ligjit.

Fidan Rekaliu, në diskutimin e tij, tha se parimisht e përkrah propozimin e Ministrisë së Financave, por propozoi që të ftohen përfaqësuesit e ministrisë për ta sqaruar propozimin e tyre.

Mevlide Shamolli tha se propozimi që është dhënë ka të bëjë vetëm me sqarimin dhe heqjen e dilemave dhe keqkuptimeve gjatë zbatimit të këtij ligji, duke pasur parasysh se në Kosovë kemi

disa lloje të skemave pensionale dhe pensioni bazë nënkupton pensionin e pleqërisë apo pensionin jo kontribut dhënës.

Ismajl Kurteshi, pas këtyre sqarimeve, kërkoi që anëtarët e Komisionit të deklarohen me votë për propozimin e ndryshimit të tekstit në amendamentit 2, që i referohet nenit 1 dhe tekstit të amendamentit 11 që i referohet nenit 7 e që ka të bëjë me zëvendësimin e fjalës **”pensionin bazë”** me fjalën **”pensionin që realizon”**.

Anëtarët e komisionit me 7 (shtatë) vota për dhe 1 (një) votë kundër përkrahen ndryshimin e propozuar në amendamentet 2 dhe 11.

Driton Çausi, në diskutimin e tij tha se kemi punuar shumë në këtë projektligji për të cilin ka pasur shumë vërejtje dhe sugjerime edhe nga organizatat ndërkombëtare lidhur me implikimet financiare, duke pasuar parasysh se si komision nuk e kemi përkrahur propozimin e Ministrisë së Financave, konsiderojë se me këtë propozim rrezikohet buxheti dhe se qëndrimi i PSD-së është që rritja e numrit të skemave pensionale është i dëmshëm për vendin nga se duhet të mendohet për të ardhmen, e jo të trajtojmë vetëm kategori të caktuara, andaj me këtë rast do të abstenoj.

Arbërie Nagavci tha se lidhur me këtë projektligj ka dhënë propozimin e saj për mënyrën e kompensimit të përfituesve në tërësi pas pensionimit, gjë të cilën komisioni nuk e ka përkrahur, andaj edhe përkundër përkrahjes së projektligjit në Komisionin për Buxhet dhe Financa me këtë rast do të abstenoj.

Mufera Sinik, në diskutimin e saj, tha se edhe përkundër asaj që komuniteti që përfaqëson nuk përfiton nga ky Ligj, ka marrë pjesë rregullisht gjatë shqyrtimit të projektligjit në mbledhjet e komisionit me qëllim të përkrahjes së projektligjit.

Komisioni pas diskutimeve, me shumicë votash, 6 (gjashtë) për dhe 2 (dy) abstenime, vendosi që raportin me rekomandime për Projektligjin nr.06/L-073 për statusin e punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës, nga viti shkollor 1990/91 deri në vitin shkollor 1998/99, ta procedojë për lexim të dytë.

4. Të ndryshme

Ismajl Kurteshi propozoi që në mbledhjen e radhës më 21.12.2018, të ftohen përfaqësuesit e Këshillit Shtetërorë të Cilësisë të AKA-së. Me këtë propozim u pajtuan anëtarët e komisionit.

Në vazhdim ngriti çështjen e punësimit të inspektorëve të arsimit nga ana e MASHT pa konkurse publike e që është në kundërshtim me Ligjin për Inspektoratin e Arsimit, me këtë rast tha që duhet paraprakisht t'i dërgohet shkresë ministrisë për të sqaruar këto çështje. Më tej tha se disa herë i jemi drejtuar me shkresa ministrisë për çështje të ndryshme, mirëpo nuk kemi marrë përgjigje për to.

Driton Çausi, ngriti çështjen e përkrahjes financiare për OJQ-në Voice of RAE, përmes një amendamenti që do ta bëjë komisioni në projektligjin e Buxhetit, për të siguruar qëndrueshmëri të qendrave mësimore të këtyre komuniteteve.

Teuta Haxhiu, lidhur me propozimin e lartpërmendur, tha se duhet ftohet ministri i MASHT me qëllim të marrjes së informatave se çfarë ka bërë ministria për këtë qendra mësimore, disa prej të cilave tha se i ka vizituar.

Arbërie Nagavci tha se duhet të ftohet ministri i MASHT- it, me qëllim të shqyrtimit të projektligjit të buxhetit për fushën e arsimit. Ajo tha se edhe përkundër një rritje të buxhetit për arsim prej 10%, nuk shihen projekte që kanë për qëllim përmirësimin e cilësisë në arsim. Sa i përket shkresës së dërguar ministrisë lidhur me ndryshimin e udhëzimit administrativ për kriteret e përzgjedhjes së drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve, tha se kjo çështje rregullohet me Ligjin për arsimin parauniversitar.

Teuta Haxhiu, në diskutimin e saj, foli për shqetësimin e ngritur nga mbi 40 studentë që kanë përfunduar programin master tek Udhëheqja në Arsim në Fakultetin e Edukimit, e të cilët janë diskriminuar në konkurset për punësim për pozitën e drejtorit apo zëvendësdrejtorit në institucionet arsimore, ndërsa janë favorizuar kandidatët që kanë përfunduar një trajnim njëzet e një ditore. Me këtë rast janë bërë shkelje të shumta ligjore si në aspektin e organizimit të trajnimit në institucionet publike, pagesës së mësimdhënësve, marrjen e certifikatave pa qenë fare në këto trajnime, si dhe kriterëve për pjesëmarrje në këto trajnime. Lidhur me këtë kërkoi shifra të sakta nga MASHT dhe llogaridhënie për të gjithë ata që kanë qenë të përfshirë në këtë proces.

Albulena Balaj-Halimaj, në diskutimin e saj, tha se MASHT ka fare pak ndikim në procesin e përzgjedhjes së drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve, sepse në këto komisione vlerësuese MASHT përfaqësohet vetëm me një anëtarë, ndërsa roli kryesor është i kryetarit të komunës sepse ai është presoni kryesor që e vë nënshkrimin. Sa i përket çështjeve të ngritura tha se shumica prej tyre janë vendime të ministrave të kaluar dhe se ministri aktual është duke bërë ndryshimet e nevojshme në udhëzimin administrativ me qëllim të tejkalimit të këtyre parregullsisë. Ajo tha se është mirë që të fillohet me ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për arsimin parauniversitar e pastaj udhëzimet administrative të nxjerrën mbi bazën e tij, sepse është e padrejtë të barazohen një trajnim njëzet e një ditore me një program Master në Fakultetin e Edukimit.

Arbërie Nagavci tha se çështja e trajnimit si kriter për zgjedhjen e drejtorit dhe zëvendësdrejtorit parashihet në Ligjin për arsimin parauniversitar, konkretisht në nenin 34. Në vazhdim ngriti çështjen e përzgjedhjes së inspektorëve të arsimit në Komunën e Malishevës pa bazë ligjore.

Teuta Haxhiu tha se qëndron prapa mendimit të saj se favorizimi i një trajnimi njëzet e një ditore i cili shpesh herë është bërë për përfitim personal nga OJQ të ndryshme në raport me një program master është i padrejtë dhe për këtë do të kërkoj raport me shkrim nga MASHT.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetari i komisionit,

Ismajl Kurteshi